



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 150 Prot.

Tiranë, më dt. 21.03.2018

VENDIM

Nr.127, dt. 21.03.2018

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 21.03.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikonstruksioni i rrugës Velipojë, segmenti Harku i Berdicës – Baks”, me subjekt aplikues FSHZH.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Ura e Baçallëkut mbi lumin Drin”, Shkodër.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të **mbikëqyren** sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Mirela Kumbaro Furxhi

